REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASETEVE

Nr 4981 Prot.

Vau Dejës me 26 . 08 . 2022

**Lënda**: Dërgohet materiali për shqyrtim dhe miratim.

**Z. Mark Bisha**

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

I nderuar z. Kryetar

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Projekt Vendimin. "Dhënie pëlqimi në parim për dhënien në përdorim të pasurisë nr 539/6, Zk nr 1329, fshati Bushat, Bashkia Vau Dejës".

Bashkëlidhur:

1. Projekt vendimi
2. Relacioni
3. Kopje e fletës së inventarit dhe VKM-në përkatëse.
4. Kopje e Kartelës së pasurisë së paluajtshme dhe Fragment harte kadastrale për pasurinë e nr 539/6, Zk nr 1329, fshati Bushat, Bashkia Vau Dejës.
5. Kopje e shkresës së ardhur nga DAMT-i për konfirmimin e zërit Kadastral "Pa fryt"

**KRYETARI**
**Mark BABANI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**
**ZV/KRYETARI**
**Kristian SHKRELI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS

*Konceptoi: Ndoc Baqli*

Datë: ________________

Nr faqeve A4 të projekt-propozimit ____

Nr faqeve A4 të dokumenteve që shoqërojne projekt-vendimin _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASETEVE

**PROJEKT VENDIM**

Nr 06.datë 18.08.2022

**Dhënie pëlqimi në parim, për dhënien në përdorim me anë të konkurimit, të pasurisë nr 539/6, (përkatësisht sipërfaqet 700 m2, dhe 290 m2), pjesë nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2625 m2, ndodhur në Zk nr 1329, e llojit "Pa fryt", në fshatin Bushat, Njesia Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës.**

Bazuar në nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja "e/1"(ndryshuar), neni 55 pika 4, të ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr 8744 datë 22.02.2001, "*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore*", i ndryshuar, në VKM nr 246 dt 31.03.2011. Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin 68, dt 31.03.2011, "*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës*", në Udhëzimin nr 13, datë 18.04.2018, "Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 54 dt 05.02.2014,"*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*", i ndryshuar, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të:

**VENDOSI**

1. Miratimin në parim të dhënies në përdorim me anë të konkurimit, të pasurisë nr 539/6, sipërfaqet 700 m2, dhe 290 m2 sipas plan rilevimeve bashkëlidhur, pjesë të sipërfaqes së përgjithshme prej 2625 m2, ndodhur në Zk nr 1329, fshati Bushat, Nj.Ad Bushat, Bashkia Vau Dejës.
2. Efektet: Jep efekte pozitive në komunitet, duke hapur vende te reja pune si dhe duke siguruar të ardhura për Bashkinë, të cilat kthehen më pas në investime publike.
3. Vlera vjetore dysheme e dhënies me qira të jetë e bazuar në Udhëzimin nr 13, datë 18.04.2018, "Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 54, datë 05.02.2014 "*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*", i ndryshuar.

4. Pas miratimit në Këshillin Bashkiak dhe shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Prefektit të Qarkut, do vazhdohet me procedurat e konkurimit, shpalljen në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe më pas me hapat e mëtejshëm te procedurës, me të gjithë elementet përbërës të saj deri në lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin fitues.

**KRYETARI**
**Mark BABANI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**
**ZV/KRYETARI**
**Kristian SHKRELI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS -

Adresa: "Rruga Qafa e Gurit" Vau Dejes, Telefon/Faks 00355 2612 0006 , e-mail: info@vaudejes.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASETEVE

Nr ______Prot                                                        Vau Dejës me ____._____2022

# RELACION

DHËNIE NË PËRDORIM TË PASURISE SHTETËRORE NR 539/6, ZK NR 1329,NË FSHATIN BUSHAT, NJESIA ADMINISTRATIVE BUSHAT, BASHKIA VAU DEJES.

**Këshillit Bashkiak Vau Dejës**

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Vau Dejës, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të tjera ka edhe administrimi dhe ruajtja e tokave dhe kategorive të tjera të resurseve si toka te pafrytshme etj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, me qëllim dhënien në përdorim me anë të konkurimit, të tretëve, me objektiv për të siguruar të ardhura për bashkinë, që më pas kthehen në investime publike.

Mirëadministrimi i Aseteve publike, është një pjesë e rëndësishme e qeverisjes lokale të mire.
Me transferimin e pronave te paluajtshme publike shtetërore në administrimin vendor menaxhimi i aseteve publike bëhet nje përgjegjësi e rëndësishme vendore në shërbim të shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin e Bashkisë.

Në këtë Projekt Vendim, ju paraqesim për propozim dhënien në përdorim me anë të konkurimit të pasurisë nr 539/6, ndodhur në Zk nr 1329 , e llojit "Pa fryt", në fshatin Bushat, ku do jepen me qira dy parcela, përkatësisht me sipërfaqe 700 m2, dhe 290 m2, pjesë të sipërfaqes së përgjithshme të kësaj pasurie prej 2625 m2.

Bazuar ne Udhëzimin nr 13, datë 18.04.2018 "*Për zbatimin e VKM nr 54, datë 05.02.2014,"Për përcaktimin e kritereve, të procedurës ë të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*", i ndryshuar, tarifa dysheme për tokat e pafrytshme nuk mund të jetë më e vogël se 27 000 lekë/Ha në vit.

Kjo pasuri ndodhet në inventarin e pronave të Bashkisë, transferuar me VKM nr 246, datë 31.03.20011,"*Për disa shtesa dhe ndryshime të VKM-së nr 68 datë 28.01.2008. për transferimin e pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi, ose në përdorim të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës*";

Nga ASHK, Drejtoria Vendore Shkodër, pas kërkesës tonë, ka ardhur shkresa me nr 6736/1 prot, datë 04.07.2022, ku kemi marrë konfirmimin e satusit Juridik, ( Kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe Fragment të Hartës Kadastrale), ku rezulton pronësia Shtet për pasurinë nr

539/6, me sipërfaqen prej 2625 m2, ndërsa nga Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës me shkresën nr 113/2, datë 28.02.2022, "Kthim përgjigje", kemi marrë konfirmimin se kjo pasuri që kërkohet të jepet në përdorim është e zërit kadstral "Pa fryt".

Pas miratimit në Këshillin Bashkiak, dhe shprehjes së ligjshmerisë nga ana e Prefektit të Qarkut Shkodër, vazhdohet procedura me të gjithë elementët e saj përbërës, deri në shpalljen e fituesit dhe lidhjen e kontratës me subjektin fitues.

Për sa më sipër, ju ftojmë për të miratuar këtë Projekt Vendim.

Duke ju falenderuar,

Hartuesit e relacionit shoqërues

Ndoc Baqli　　　Armand Filipi　　　Ilda Prendi

**KRYETARI**
**Mark BABANI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**
**ZV/KRYETARI**
**Kristian SHKRELI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS -

Nr. 3560/1 Prot
07.08.07.22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS**
**DREJTORIA VENDORE SHKODËR**

Nr 6736/1 Prot.

Shkodër më 04.07.2022

*(lutemi referojuni në rast përgjigje)*

**Lënda:** *Kthim përgjigje*

**DREJTUAR:** **BASHKISE VAU DEJES**
**DREJTORISE JURIDIKE PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT**
**SHKODËR**

Në vijim të kërkesës suaj me nr.3560 prot dt.22.06.2022, protokolluar prane zyres sone me **nr.6736 prot. dt.27.06.2022 ,**lënda "Kërkesë për lëshim kopje kartele pasurie të paluajtshme dhe fragment të hartës kadastrale", konkretisht kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe kopje fragment harte kadastrale , vetëm për pjesën që rezulton në pronësi të SHTET , pas transaksioneve te kryera nder vite mbi pasurinë nr.539/2 e cila ndodhet në inventarin e pronave të BAshkisë Vau Dejes , transferuar me VKM nr.246 dt.31.03.2011 ,bashkëlidhur po ju dërgojmë :

Kopje të kartelës së pasurisë nr. 539/2 volum 5 faqe 187 ZK 1329 Bushat , afishuar ne favor te shtet , statusi i pasurise "e mbyllur" që ka vijuar tek pasuria nr.539/3 volum 7 faqe 209 me siperfaqe 3375 m2 e afishuar ne favor te shtet , me status "e mbyllur",**fragment harte kadastrale** dhe **kartela e pasurisë nr. 539/6 volum 7 faqe 248 me siperfaqe totale 2625 m2 e llojit "arë" e afishuar ne favor te "SHTET", me sttaus juridik aktiv.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj!

**DREJTORI**

**LELA BERDICA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

# FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE: 1329

KODI UNIK:________________

NUMRI PASURISË :539/6

INDEX I HARTËS:K-34-76- (18-C)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE




SH 1:2500

DREJTORI
(Emer Mbiemer)

Data e leshimit __/__/____

SHPJEGU

PARCE

NDERT

Miratuar nga V. K. M. Nr. 519, Datë 7.11.1994

# KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol. 7, Fq. 248

## A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

--> Vijon nga: Vol. 7, Fq. 209

Zona Kadastrale: 1324 NR. i PASURISE: 539/6

Indeksi i Hartës: K-34-96-(18-c)

Vijon në: Vol.______, Fq.______ deri në: Vol.______, Fq.______

PERFUNDIMTARE (data): 8/05/ 2?

**Adresa e pasurisë** : Rrethi Shkodër Q/F Bushat

Rr/L ______ P/G ______ Sh ____ K ____ Ap ____

Përshkrim i Veçantë

## B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

| Lloji i Pasurisë : Arë | Brenda V.K.N. : Jo ---> Po, Ref : ______ |
|---|---|

| Sip. Totale e Pasurisë | Nga Sip. Totale: sa Truall | Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë |
|---|---|---|
| 1. 2625 m² Ref P539 | 1.____ m² Ref____ | 1.____ m² Ref____ |
| 2.____ m² Ref____ | 2.____ m² Ref____ | 2.____ m² Ref____ |
| 3.____ m² Ref____ | 3.____ m² Ref____ | 3.____ m² Ref____ |
| 4.____ m² Ref____ | 4.____ m² Ref____ | 4.____ m² Ref____ |

Për pjesën e përbashkët:

PALLAT

Kuota e Pjesëmarrjes: ______ %

Nr. i Pasurisë (Pallat): ______

Vol.______ Fq. ______

## C - SEKSIONI I PRONESISE

| Nr.Dok | Data Regjistrim | Emri Atësia Mbiemri | Nr. Pasap | I/F/B | Adresa e Pronarit | Shuma e Paguar | Data e Lësh. Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 0539 | 2-5-96 | Shtet | | | Shkodër - Bushat | | | | |

... person fizik ose juridik, F - përfaqësues i familjes; B - bashkëpronar ( % )

Firma

Firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes se Tokes

Nr. 113/2 prot.

Shkodër, me 28.02.2022

Lënda: Kthim Pergjigje

BASHKISE VAU – DEJES

(Sektori i Aseteve)

Në përgjigje te kerkeses Tuaj nr.778 prot. date 18.02.2022, administruar nga Keshilli i Qarkut me nr.113 prot. date 22.02.2022, me objekt; "Kërkese për konfirmim të zërit kadastral", për nr. e pasurise 85/3, 539/6 dhe 539/2, ne zonen kadastrale 1329, fshati Bushat, ju sqarojme si me poshtë:

Gjurma e siperfaqja e pasurise nr.85/3 ZK. 1329, (sipas plan-rilevimit), shtrihet pjeserisht në ngastrat "79, 85" sipas Librit te Ngastrave (LN) te vitit 1991, Sektori "Bushat-Shkjeze" e Koop. Bujq. "Bushat-Shkjeze".

Gjurma e siperfaqja e pasurise nr. 539/6, 539/2 ZK. 1329, (sipas plan-rilevimit), në teresine e dy pasurive shtrihet në ngastrat "536/1 dhe 539" sipas Librit te Ngastrave (LN) te vitit 1991, Sektori "Bushat-Shkjeze" e Koop. Bujq. "Bushat-Shkjeze".

Bashkangjit ju dergojme kopje te dokumentacionit kadastral LN dhe fragment te hartes kadastrale shk. 1: 5000 viti 1985 nga ku percaktohen lloji kadastral i pasurive, objekt kerkese.

P/DAMT

Gafurr TERNOVA

formë Nr. 1

| Numri i ngastrës | Zëri kadastror | Sipërfaqja Ha | a | m3 | Shënime | Numri i ngastrës | Zëri kadastror | Sipërfaqja Ha | a | m3 | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 537 | Truall | | 1 | 50 | | 556 | P.F | | 18 | 00 | |
| 538 | Truall | | 2 | 00 | | 558 | Pemtore | | 4 | 50 | |
| 539 | P.F. | | 71 | 00 | Shkolla | | Troje | | 5 | 00 | |
| 540 | Troje | | 30 | 00 | | 559 | Pemtore | | 9 | 00 | |
| 542 | P.F | | 51 | 00 | | 560 | are | | 36 | 00 | ✓ [illegible] |
| | Troje | | 9 | 00 | | 561 | are | 2 | 86 | 00 | ✓ [illegible] |
| 544 | P.F | | 23 | 00 | | 562 | are | | 3 | 00 | ✓ |
| | Troje | | 12 | 00 | | 563 | P.F | | 1 | 00 | |
| 545 | Troje | | 4 | 00 | | | Truall | | 2 | 00 | |
| 546 | Pemtore | | 5 | 00 | | 565/1 | Pemtore | | 24 | 00 | |
| | Truall | | 3 | 00 | | | Truall | | 1 | 00 | |
| 547 | P.F | | 5 | 50 | | 566 | P.F | | 1 | 00 | |
| | Truall | | 2 | 00 | | | Truall | | 2 | 00 | |
| 548 | are | | 5 | 00 | ✓ | 569/3 | are | 5 | 41 | 00 | ✓ |
| | Truall | | 1 | 00 | | 574 | Pyll | 2 | 29 | 00 | ✓ |
| 549 | Pemtore | | 7 | 00 | | 575 | P.F | | 15 | 00 | ✓ |
| | Truall | | 2 | 00 | | 576 | Pemtore | | 12 | 00 | ✓ |
| 550 | Truall | | 2 | 00 | | 577 | Troje | | 3 | 00 | ✓ |
| 551 | P.F | | 4 | 00 | | 578 | Pemtore | | 13 | 00 | ✓ |
| | Troje | | 6 | 00 | | 579 | Pemtore | | 20 | 50 | ✓ |
| 552 | P.F | | 31 | 50 | | 580 | Troje | | 8 | 50 | ✓ |
| | Truall | | 2 | 50 | | 581 | Troje | | 8 | 00 | ✓ |
| 553 | Troje | | 86 | 00 | N. Sh. G | 582 | Pemtore | | 2 | 00 | ✓ |
| 554 | Troje | 3 | 03 | 00 | N. Sh. G. | | Truall | | 2 | 00 | ✓ |
| 554/1 | are | | 8 | 00 | ✓ | 583 | are | 2 | 39 | 00 | ✓ ✓ |
| | Shuma 29 | 6 | 77 | 00 | | | Shuma 30 | 14 | 80 | 50 | |

SEKRETARIA
BASHKIA VAU I DEJËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

# VENDIM

Nr. 246 , datë 31.3.2011

PËR

## DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.68, DATË 28.1.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS BUSHAT, TË QARKUT TË SHKODRËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike, të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të komunës Bushat, të qarkut të Shkodrës, i shtohen pronat me nr. 517 – 2312 (pesëqind e shtatëmbëdhjetë – dymijë e treqind e dymbëdhjetë), gjithsej 145 (njëqind e dyzet e pesë) fletë, sipas lidhjes 2 dhe formularëve, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Në listën përfundimtare të inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 68, datë 28.1.2008, të Këshillit të Ministrave, miratohen ndryshimet sipas listës që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, gjithsej 6 (gjashtë) fletë.

3. Ngarkohen ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Bushat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në " Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

SALI BERISHA

ZËVENDËSMINISTRI I BRENDSHËM

AVENIR PEKA

Komuna Bushat

Lidhja 2

| | | |
|---|---|---|
| 517 - 633 | Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka jo produktive ) | Në pronësi |
| 634 - 689 | Infrastrukturë (troje të lira) | Në përdorim |
| 690 - 783, 831, 832, | Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive). | Në përdorim SAMT qarku Shkodër ka vene ne dispozicion te AKKP-së nga kjo komunë sipërfaqen prej 194 ha tokë bujqësore e shtrirë në 19 parcela dhe sipërfaqen prej 261.4 ha , tokë bujqësore e shtrirë në 20 parcela. |
| 880 - 889, | Infrastrukturë rrugore vendore | Në pronësi |
| 928 - 931 | Shërbime funerale (Varreza) | Në pronësi |
| 932 | Prona që përdoren në fushën e kulturës dhe sportit. | Në pronësi |
| 933 - 936, 937,938, 939 - 942, 943, 944 - 1721, 1792 | Rrugë dhe kanale të treta | Në pronësi |
| 784, 785, 785/1, 786, 787 - 830, 833 - 879 | Kullotë | Në pronësi |
| 1793 - 2312 | Rrugë rurale dhe kanale të treta | Në pronësi |
| | Në listën e ndryshimeve, pasuria me nr. 18, zona kadastrale 3205, lloji i pasurisë arë, sipërfaqja 81090 m2, me VKM nr. 400, datë 08.04.2008 ka kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë. (Çetrifikatë për vërtetim pronësië nr. 33, datë 03.07.2008) | Nuk transferohet |

MINISTRI

LULZIM BASHA

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 700 | 1329<br>( 33-B) | 504 | are | are Bushat | 1500 | | are | Komuna Bushat | Komuna Bushat | SHTESE |
| 701 | 1329<br>(18-C) | 539/2 | are | Bushat | 3375 | | are | Komuna Bushat | Komuna Bushat | SHTESE |
| 702 | 1329<br>(18-C) | 542/5 | are | are Bushat | 125 | | are | Komuna Bushat | Komuna Bushat | SHTESE |
| 703 | 1329<br>(18-C) | 549/1 | are | are Bushat | 250 | | are | Komuna Bushat | Komuna Bushat | SHTESE |
| 704 | 1329<br>(34-A) | 549/9 | are | are Bushat | 1325 | | are | Komuna Bushat | Komuna Bushat | SHTESE |
| 705 | 1648<br>75<br>(48-A) | 38 | are | are Fshati I Ri | 5280 | | are | Komuna Bushat | Komuna Bushat | SHTESE |
| 706 | 1648<br>(63-B) | 108/11 | are | are Fshati I Ri | 4770 | | are | Komuna Bushat | Komuna Bushat | SHTESE |
| 707 | 1648<br>(48-D) | 293/38 | are | are Fshati I Ri | 585 | | are | Komuna Bushat | Komuna Bushat | SHTESE |
| 708 | 2236<br>64(242-B) | 13 | are | are Kosmac | 5150 | | are | Komuna Bushat | Komuna Bushat | SHTESE |
| 709 | 2236<br>(242-B) | 15 | are | areKosmac | 450 | | are | Komuna Bushat | Komuna Bushat | SHTESE |
| 710 | 2236<br>(242-B) | 16/1 | are | are Kosmac | 1825 | | are | Komuna Bushat | Komuna Bushat | SHTESE |
| 711 | 2236<br>(242-B) | 19/1 | are | are Kosmac | 7900 | | are | Komuna Bushat | Komuna Bushat | SHTESE |
| 712 | 2236<br>(242-D) | 22/3 | are | are Kosmac | 1020 | | are | Komuna Bushat | Komuna Bushat | SHTESE |
| 713 | 2236<br>(242-D) | 22/3 | are | are Kosmac | 980 | | are | Komuna Bushat | Komuna Bushat | SHTESE |
| 714 | 2566<br>76 (49-B) | 175/1 | are | are Mali I Jushit | 12528 | | are | Komuna Bushat | Komuna Bushat | SHTESE |

SEKRETARIA SHKIA VAU I DEJËS

REPUBLIKA E SHQIPERISE - KOMUNA - BUSHAT -